



Pranimi / Dorezuar Prilpjen / Predato Received / Delivery	02.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHICK	7616/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.989/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.989/2022 të datës 10.11.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë banimi .undër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02. 12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.989/2022 e datës 10.11.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjakovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore-administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së nëpunës civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 10.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7001/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, me pretendimet për njohje të së drejtës për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës. Ndërsa Këshilli, me datë 29.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokolli 7449/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7001/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 28.10.2022 me nr.01-120/01-24588 për Njësine e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës ; Përgjigje në kërkesën nr. 01-120/01-24588 e datës 11.10.2022; Akt emërimi i datës 02.06.2017 me nr.01-112/01-14153; Vendimi i datës 11.07.2018 me nr.01-112/01-20380; Akt emërimi i datës 14.12.2021 me nr.01-112/02-37480; Akt emërimi i datës 24.12.2021 me nr.01-112/02-37479; Akt emërimi i datës 15.07.2021 me nr.01-112/02-18220; Akt emërimi i datës 13.12.2020 me nr.01-112/02-37391; Akt emërimi i datës 13.12.2021 me nr.01-112/01-37322; Akt emërimi i datës 16.08.2021 me nr.01-112/01-20709; Vendimi i datës 30.11.2021 nr.01-102/02-35987; Vendimi i datës 21.04.2022 me numër protokolli 2312/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; .. Vendimi i datës 12.10.2022 me numër protokolli 6121/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2022 me numër protokolli 7124/2022 dhe Përgjigje në ankesë e datës 29.11.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 7449/2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, **SEPSE:**


Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja sipas vendimit të datës 11.07.2018 me nr.01-112/01-20820 është transferuar nga pozita Udhëheqëse e Sektorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas Akt Emërimit me numër reference 01-112/02-37480 të datës 14.12.2021, në Komunën e Gjakovës me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5). E njëjta më datë 28.10.2022, parashtron kërkesë të Menaxheri i Burimeve Njerëzore për harmonizim (ngritje) të koeficientit nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes përgjigjes me numër reference 01-120/01-24588 të datës 31.10.2022 ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga ankuesja me arsyetimin së pozitën për udhëheqës të sektorëve çdo herë i ka shpallur dhe rekrutuar duke u bazuar në katalogun e titujve të vendeve të punës, të cilët janë me gradën 7, sipas koeficientit 7.5 dhe sipas nenit 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Institucionet e Republikës së Kosovës kanë qenë të detyruara që të bëjnë klasifikimin , harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje. Po ashtu në shkresën me shenjë DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil konkursi juaj për këtë pozitë do duhej të shpallej sipas koeficientit 8.5.

E pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesja me datë 10.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen të së drejtës për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), sikurse për pozitat e njëjta të Udhëheqësve të Sektorëve në Komunën e Gjakovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *"1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...."*, dhe rrjedhimisht konstatoj së e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë.

Andaj, në vështrim të dispozitave ligjore si me lartë bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së organi i punësimit respektivisht Komuna e Gjakovës lidhur me udhëheqësit e sektorëve si pozita të kategorisë së njëjta aplikon koeficient të ndryshëm të pagës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit për Mirëqenie Sociale ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës; Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Profesionale ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës; Udhëheqësi i Sektorit të Gjendjes Civile ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës; Udhëheqësi i Prokurimit ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës; Udhëheqësi i Sektorit të Buxhetit ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës dhe Zyrtari për Informim në kuadër të Sektorit për Raportim. Informim dhe Bashkëpunim-Zyra e Kryetarit caktohet zëvendësues i Udhëheqësit të Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim ka koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës i cili është caktuar sipas vendimit me nr.01-112/02-35987 të datës 30.11.2021 ndërsa ankuesja .Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë me koeficient 7. 5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda institucionit të njëjtë punëdhënës ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji"*, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit trajtimi jo i barabartë dhe diskriminues i të punësuarve të njëjtit institucioni në kuptim të së drejtës së pagës është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*

Nisur nga konstatimet si me lart, si dhe duke u bazuar në shkresën me shenjë DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil si organi përgjegjës për përgatitje dhe mbikëqyrje të politikave lidhur me pagat e



nëpunësve civilë, sipas së cilës shkresë për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* është përcaktuar koeficient tetë pikë pesë (8.5) i pagës, Kolegji konstaton së në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e tërësishëm të ankesës së ankueses duke i dhënë të drejtë ankueses për rregullimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5), në tetë pikë pesë (8.5), për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSOR PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.989/2022, datë 02.12.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

